



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 96/2017

Prishtinë, më 27.4.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Besim Beqaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: Driton Gjonbalaj, drejtor i AAC.

Pjesëmarrës të tjerë: Xhelil Bekteshi, AAC; Elteva Malushaj, LVV; Dardan Abazi, INDEP; Blerta Aliu dhe Ahmet Rushiti, KDI; Kreshnik Kurtishi dhe Liridon Shurdhani, USAID PFD.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12 dhe 19.4.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-158 për Shoqëritë tregtare;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC, për vitin 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Kryetari i Komisionit, z.Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit dhe në emrin e tij, shprehu kënaqësinë e të gjithë anëtarëve, që z. Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, sot u lirua nga Gjykata në Colmar të Francës, si i pafajshëm dhe i akuzuar pa të drejtë dhe shprehu kënaqësinë që ai sot po i kthehet vendit të tij, familjes së tij, punëve të tij. Po ashtu, i dëshiroi shëndet atij dhe familjes së tij, dhe AAK-së, punë të mbarë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12 dhe 19.4.2017

Procesverbalet e datës 12 dhe 19.4.2017, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-158 për Shoqëritë tregtare

Kryetari, theksoi se në mbledhjen e kaluar, ne kemi miratuar raportin me amendamente, të cilin e kemi dërguar në komisionet e përhershme të Kuvendit, të cilat e kanë trajtuar brenda afatit të paraparë, nuk kanë dhënë asnjë vërejtje dhe janë krijuar kushtet që ne ta miratojmë raportin me rekomandime dhe ta dërgojmë për lexim të dytë në Kuvend.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-158 për Shoqëritë tregtare.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC për vitin 2016

Kryetari, theksoi se kemi marrë raportin vjetor, por kemi edhe një raport shtesë, ku janë pasqyruar aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, të dala nga shqyrtimi i raportit të vitit paraprak dhe ftoi z. Driton Gjonbalaj, të bëjë prezantimin e raportit.

Driton Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i AAC-së, theksoi se AAC-ja themelohet nga Ligji për aviacionin civil, si agjenci e pavarur rregullatore përgjegjëse për rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Ai potencoi se institucionet kryesore publike, me përgjegjësi në aviacion, janë: MTPT-ja, AAC-ja, MPB-ja dhe KHAIA. Gjatë vitit 2016, inspektorët e sigurisë së fluturimeve të AAC-së, kanë kryer 54 inspektime të sigurisë së aeroplanëve, të cilët operojnë në ANP “Adem Jashari” dhe në asnjë rast nuk është gjetur ndonjë parregullsi, që ka mundur ta

rezikojë sigurinë. Në vazhdim, z. Gjonbalaj potencoi se janë lëshuar 58 leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme, përmes ajrit. Këto leje u janë lëshuar kompanive të ndryshme, paraprakisht të licencuara nga ana e MPB-së për import të armëve dhe municionit. Është bërë licencimi i pilotëve të aviacionit të përgjithshëm, si dhe certifikimi i instruktorëve të parë kosovarë, certifikimi i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, certifikimi mjekësor i anëtarëve të ekuipazhit të kompanive të huaja ajrore, kontrollorëve të trafikut ajror dhe pilotëve nga Shqipëria. Është bërë mbikëqyrja e riallokimit të kullës së kontrollit të trafikut ajror në objektin e ri dhe riallokimit të pajisjeve. Po ashtu, janë realizuar inspektime të shumta në ANP “Adem Jashari”. Ai potencoi se AAC-ja, ka miratuar një program nxitës për kompanitë ajrore. Ka vazhduar mbikëqyrja ekonomike e ANP “Adem Jashari”, ASHNA dhe ofruesve të shërbimeve në tokë. Janë miratuar tarifat për shërbimet e navigimit ajror. Në treg kanë hyrë dy kompani të reja me çmime të lira. AAC-ja ka nxjerrë katër rregullore, për të reflektuar zhvillimet e fundit legjislative në rrafshin ndërkombëtar. Janë nxjerrë edhe manualët përkatëse për zbatimin e këtyre rregulloreve për industrinë e aviacionit dhe inspektorët tanë. AAC-ja është certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015, deri në nëntor të vitit 2019. Kjo certifikatë dëshmon përputhshmëri të plotë të sistemit të menaxhimit në AAC, me standardin për menaxhim të cilësisë. AAC-ja, gjatë vitit 2016, ka publikuar përmbledhjen mujore të aktiviteteve kryesore, të cilat i ka shpërndarë te palët e interesit, përmes email-it, në formë të buletinit. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, ka shënuar rritje të numrit të udhëtarëve për 13%, krahasuar me vitin 2015. Buxheti i AAC-së, për vitin 2016, është realizuar 98% e buxhetit të miratuar. Plani i punës është përmbushur në masë të madhe rreth 90%, ndërsa veprimet që nuk janë realizuar gjatë vitit 2016, kanë qenë të ndërlidhura me aktivitetet e prokurimit dhe për shkak të mungesës së buxhetit për aktivitetin e kontraktuar për përkthim të dokumenteve. Ndërsa, veprimet si anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të aviacionit dhe hyrja në aranzhime kontraktuese ndërkombëtare, kanë qenë të varura nga rrethana politike dhe ligjore jashtë kompetencave vendimmarrëse të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Muhamet Mustafa, theksoi se raporti dhe prezantimi ishte mjaft detal dhe jep një pasqyrë për një aktivitet të rëndësishëm, që zhvillohet në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Shohim se pas dy-tri vitesh, rënie të numrit të udhëtarëve në vitet 2014-2015, në 2016 e tejkalon numrin e 2013-2012 dhe ky është një lajm i mirë. Në raport nuk mund të gjesh koston e biletave në Prishtinë, në krahasim me destinacionet tjera. Po ashtu, çmimet, ndoshta do ishte më mirë që të kemi një hulumtim dhe në raportet e ardhshme të kemi konkurrencën në mes aeroportit tonë dhe aeroporteve të tjera, si dhe koston. Ky komision nuk mund të jetë indiferent se çfarë kostoje të biletave po e paguajnë punëtorët tanë, sidomos gjatë pushimeve verore, ndoshta duhet tërhequr vërejtjen që mos të shkohet në ngritjen e çmimeve të larta gjatë verës dhe të shikohet, se me cilat masa mundemi ne të zbusim këtë ngritje të çmimeve gjatë verës, që sidomos është e dëmshme për diasporën tonë. Të na jepni më shumë sqarime lidhur me disa çështje të ngritura nga shoqëria civile, me një raport që e kemi marrë, për numrin e operatorëve, listave, lejeve, taksën prej 2 eurosh, $\frac{1}{4}$ e të cilës i dedikohet AAC-së, pjesa tjetër ku mbetet, të sqarohet kush e paguan këtë taksë, po ashtu dënimin e drejtorit për mosfunksionim të radarëve nuk e kemi në raport. Lidhur me rekomandimin tonë, po shihet se aktivitetet në zbatim të tyre kanë shënuar një përparim, por të vazhdoni edhe më tutje në zbatim të tyre. Lidhur me zbatimin e kontratës së koncesionit të aeroportit, çka po ndodh dhe mund të këshilloni edhe Komisionin, Kuvendin për masat që duhet marrë për zbatim të asaj kontrate.

Fatmir Rexhepi, theksoi se ky raport është një ndër informatat më të kompletuara që mund të bëjë një agjenci. Puna gjatë vitit paraprak e paraqitur në raport, po edhe e shprehur gojarisht nga drejtori, por edhe çka është në raport mund të vlerësohet dhe më të drejtë mund të them se është një ndër agjencitë që do të duhej të jetë model për nga ana e menaxhimit në Kosovë. Andaj, edhe kolegët tjerë të marrin edhe shkollë, edhe të shohin sesi duhet punuar brenda një agjencie. Unë vetëm mund ta përkrahu dhe t'ju dëshiroj punë të mbarë, se kështu duhet punuar për agjencinë, kështu duhet punuar për vendin.

Raif Qela, potencoi se ky është një raport, ku në përgjithësi, duket që është i gjithanshëm, një institucion që i kryen punët e veta si duhet. Përkundër kësaj, raportit mund t'i shtoheshin edhe disa detaje, se është dashur të futej në raport edhe mosfunksionimi i sistemit të radarit të Goleshit për tri ditë dhe është mirë që të na jepen disa informata edhe më të hollësishme se si keni bërë zgjidhje alternative të tjera, në mënyrë që të jemi të informuar më mirë. Lidhur me listat e operatorëve lokalë me licenca dhe me leje të lëshuara në vitin 2016, sa janë të paraqitura në raport? Të sqaroni lidhur me mundësinë që taksat e dedikuara për AAC-në, të ulen dhe kjo ndikon drejtpërsëdrejti edhe në çmimin e përgjithshëm, që të mos dëmtohet udhëtari. Pastaj në sigurinë që mund të ketë, mospërmbushja e plotë e kontratës nga koncesionari, për shkak të pengesave të tjera, në rend të parë, për shkak të problemeve me zgjatjen e pistës. Po ashtu, të sqarohet platforma për shkrirjen e akullit, pastaj edhe me zgjerimin e pistës dhe sigurimin në fund të pistës. Këto janë çështje, ku ju vetëm e keni dhënë përgjigjen zyrtare, se këto nuk pengojnë në sigurinë në trafik, sikur e kemi parë deri më tani, sepse nuk ka pasur asnjë incident, për shkak të asaj natyre. Megjithatë, a ndikon kjo në sigurinë në përgjithësi dhe a do të jetë edhe më e sigurt pista që zgjatet edhe për 500 metra, apo zgjatja e pistës është për shkak të avionëve që kanë destinacion të gjatë?

Sala Berisha- Shala, potencoi se rritja e konkurrencës shkon në favor të qytetarit, është njoftim për qytetarët dhe kisha dëshiruar ndoshta me i përmend këtu pse jo se cilat janë ato kompani. E dimë se një kompani ajrore subvencionohet në Maqedoni, deri ku ka shkuar procesi i kompanisë dhe a është e njëjta kompani që tani fluturon edhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" dhe a është në pyetje që ka subvencionuar si shtet apo kompania si kompani i ka planifikuar edhe shpenzimet e veta?

Driton Gjonbalaj, sqaroi se tarifa e përgjithshme e një udhëtari në nisje nga Aeroporti i Prishtinës është 20 euro, 2 nga këto euro shkojnë si të hyra dedikuar për Autoritetin e Aviacionit Civil, sipas Ligjit për aviacionin civil edhe sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike. Këto të hyra, si çdo e hyrë tjetër, shkojnë si të hyra të dedikuara në thesarin e Republikës së Kosovës. Pra, edhe ne, si çdo institucion tjetër, si çdo organizatë tjetër buxhetore, bëjmë kërkesë buxhetore. Ne përpiqemi që kërkesat tona buxhetore t'i bëjmë të arsyeshme dhe të reflektojnë në të hyra, të cilat i kemi pasur, por buxheti i cili na miratohet neve në të hyra, nuk e kalon 60% e të hyrave të mbledhura. A duhet tarifa të jetë më e madhe sesa të hyrat që i jepen AAC-së? Mendimi im është jo, por sidoqoftë janë institucionet tjera që e menaxhojnë buxhetin e shtetit, të cilat vendosin, por ne nuk i marrim të hyrat e dedikuara për Autoritetin e Aviacionit Civil. Lidhur me dënimin që Ministria e Infrastrukturës i ka vënë Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, nuk bëhet fjalë për dënim të individit, por është një gjobë për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është çështje midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, e cila është jashtë fushëveprimit tonë.

Radari i Goleshit, tri ditë me radhë nuk ka funksionuar, por ju siguroj që mosfunksionimi i radarit, në asnjë rrethanë, nuk e cenon aspak sigurinë, nëse me radar funksional mund të procesohen 20 fluturime në orë. Pra, kur nuk funksionon radari, zvogëlohet numri i fluturimeve që procesohen brenda orës. Në rrethana të tilla, lejohet vetëm një fluturim të jetë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, deri në aterrim, pastaj vjen tjetri. Ngarkesa nuk është aq e madhe sa të ketë fluturime në pritje. Kontrollorët tanë të trafikut ajror kanë licencë edhe për kontroll radar, por edhe për atë që e quajmë procedural. Ka shtet që nuk kanë fare radar dhe funksionojnë edhe me numër më të madh të udhëtarëve dhe kjo nuk e cenon në asnjë rrethanë fluturimin, masat shtesë të sigurisë rriten dhe duhet të jenë shumë vigjilent. Në fakt, ata kanë pasur radar, mirëpo ne nuk i kemi pranuar si të besueshëm, për shkak se ka pasur interferenca, është përdorur ekrani i radarit për informata, por jo si bazë për veprimet e tyre, në asnjë moment dhe në asnjë rrethanë, nuk e lejon Autoriteti i Aviacionit Civil që të cenohet siguria. Ne kemi kompetencë ta mbyllim hapësirën ajrore të Kosovës. Arsyeja pse nuk është lista e kompanive ajrore që janë miratuar të fluturojnë në Kosovë, është thjesht, sepse Autoriteti i Aviacionit Civil nuk i miraton kompanitë ajrore për të operuar në Kosovë. Pra, është Ministria e Infrastrukturës që lëshon leje për operime në Kosovë. Çështja e implementimit të plotë të marrëveshjes së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", nga këndvështrimi ynë, disa detyrime koncesionari nuk ka mundur t'i përfundojë, si shtrimin e fundit të pistës me material rigjid, që quhet "resa". Aeroplani që mund të rrëshqasë në pistë duhet të ketë një hapësirë shtesë me zhavorr, e cila ndihmon që të frenohet pa u dëmtuar aeroplani. Rrotat natyrisht thyhen, por shpëtohen udhëtarët. Kjo është rindërtuar sipas rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Pra, detyrimi i Autoritetit të Aviacionit Civil është të konfirmojë që resa ekzistuese është në përputhje me Ligjin për aviacionin civil. Ajo që koncesionari është zotuar në kontratë, është standardi plus. Sipas informatave që kemi, është bërë me një arsye, sepse planifikohet zgjatja e pistës për 500 metra, dhe po që se do të ndërtohej sot, fundi i pistës me zhavorr sipas standardit që e ka përcaktuar kontrata e koncesionit dhe në qoftë se do të vendoset që të zgjatet pista, ajo duhet të prishet dhe të zgjatet, dhe në fund, te 500 metërshi i ri, të ndërtohet dhe ka një mirëkuptim të mirë midis palëve që resa e re, të ndërtohet pas zgjatjes së pistës. Kjo zgjatje, jo vetëm që do të ndihmojë në akomodimin e avionëve të mëdhenj në Aeroportin e Prishtinës, por është shumë e rëndësishme edhe për sigurinë e operimeve. Nuk them që operimet tani nuk janë të sigurta, mirëpo nëse një aeroplan ka problem në aterrim, po e zëmë me flatrat e krahëve që i duhen për të frenuar më shpejt, pista 2500 metra nuk mjafton. E kemi pasur një rast para disa viteve, tani për tani mjafton, mirëpo nëse ka defekt në krah, duhet të aterrojë në një pistë më të gjatë. Kemi pasur një rast në 2008, kur një aeroplan ka pasur një problem të tillë dhe nuk ka mundur të aterrojë as në Prishtinë, as në Podgoricë e as në Shkup, është dashur të shkojë në Sofje, që të mund të aterrojë. Çka është mjaft e rëndësishme, Qeveria ka miratuar edhe ngritjen e nivelit të sistemit instrumental të aterrimit, i cili do të mundësojë aterrim në dukshmëri shumë të vogël, që nuk mund të jetë në Prishtinë dukshmëri aq e vogël, me një fjalë nuk do të ketë asnjë lloj anulimi, për shkak të mjegullës. Platforma për shkrirjen e akullit është një ndër projektet që nuk ka mundur të zbatohet, sepse kur ka filluar punimi i platformës së re për shkrirjen e akullit dhe një hapësirë ku zjarrfikësit do të bënin ushtrime në fikjen e zjarreve, KFOR-i i ka dërguar letër UNMIK-ut dhe i ka thënë që LIMAK-u është duke ndërtuar në tokën e menaxhuar nga KFOR-i, një pjesë e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sipas një marrëveshjeje të vitit 2003, midis UNMIK-ut dhe KFOR-it, është në përgjegjësi ekskluzive të KFOR-it dhe mund të shfrytëzohet vetëm për nevoja ushtarake. Ajo platformë e re do ta përshpejtonte procedimin e aeroplanëve në kohën e dimrit,

mirëpo mungesa e saj, në asnjë rrethanë, nuk e cenon sigurinë e operimeve. Sqaroi se dy kompanitë e reja me çmimet e lira, që kanë hyrë në tregun tonë janë “Easy Jet” dhe kompaninë “Vizz Air”, është pikërisht ajo kompani, për të cilën ne e kemi akuzuar Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për subvencionim të padrejtë për ndihma që ne i quajmë ilegale. Lidhur me subvencionimin e kompanisë në Maqedoni, Komisioni Evropian, në hetimet e deritanishme, është plotësisht dakord me atë, të cilën e kemi thënë ne, mirëpo ende nuk kanë mundur që ta nxjerrin një vendim detyrues, për shkak se marrëveshja për hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit, ende nuk ka hyrë në fuqi. Pra, zyrtarisht të gjitha shtetet e kanë ratifikuar, mirëpo janë disa procedura të brendshme në institucionet e BE-së. Kompania “Vizz Air”, që ka filluar të fluturojë në Prishtinë, kjo është një linjë e subvencionuar jo vetëm në Prishtinë, por edhe fluturimet midis Budapestit, Prishtinës, Tiranës, Shkupit, Podgoricës dhe Sarajevës, kanë filluar në të njëjtën kohë dhe besoj që shumë shpejt do të fillojë edhe në destinacione të tjera, sepse destinacionet tjera nuk do të jenë të subvencionuara.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil (në tekstin e mëtejme: AAC), për vitin 2016, me rekomandimet si në vijim:

- a) AAC-ja të vazhdojë me ndërmarrjen e masave nga fushëveprimi i vet, në funksion të rritjes së mëtutjeshme të konkurrencës dhe uljes së çmimeve të udhëtimit, sidomos në periudhën e pushimeve verore dhe dimërore të diasporës sonë.*
 - b) AAC-ja të realizojë një hulumtim, duke krahasuar konkurrencën e Aeroportit të Prishtinës, me aeroportet tjera në rajon dhe krahasimin e çmimeve të udhëtimit nga dhe për në Aeroportin e Prishtinës, me destinacionet e ngjashme nga aeroportet tjera në rajon.*
 - c) Të inkurajohet AAC-ja, që në koordinim me të gjitha institucionet kompetente, të vazhdojë të angazhohet për anëtarësimin e AAC-së në organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil, si dhe për normalizimin e plotë të hapësirës së ulët ajrore, me hapjen e korridoreve të reja ajrore me shtetet fqinjë.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime, e paraqet kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa.*

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Sala Berisha-Shala, propozoi që shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale mos të bëhet javën e ardhshme, sepse, ajo, por edhe zyrtarët e KPMM-së, janë jashtë vendit në një konferencë ndërkombëtare në Nju-Jork.

Komisioni e përkrahu propozimin e znj. Sala Berisha-Shala.

Kryetari, theksoi se është vonuar shumë raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe propozoi që të kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik një informatë për arsyet e vonesës, si dhe të kërkohet që ky raport të vijë sa më shpejt. Po ashtu, theksoi se tashmë është bërë temë çështja e ndërmarrjes publike “Vala dhe Telekom i Kosovës” dhe ne si komision i fushës përkatëse, duhet t’i qasemi këtij problemi. Kryetari propozoi që të kërkohet informatë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me gjendjen në ndërmarrjen “Vala dhe Telekom i Kosovës”, duke përfshirë sqarimin e kontestit në arbitrazh.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa